

URDHËR
Nr. 657, datë 28.9.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të nenin 5, të ligjit nr. 8038, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar,

URDHËROJ;

1. Delegimin e kompetencës Institutit të Transportit për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e aplikimeve dhe marrjen e vendimeve për miratimin e licencave nëpërmjet QKB-së, në veprimtarinë e nënkategorisë VII.3.B, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Instituti i Transportit të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, dhe në kuadrin ligjor në fuqi.

3. Ngarkohet Instituti i Transportit për zbatimin e këtij urdhri dhe koordinimin me QKB-në për zbatimin e procesit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri